



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_. \_\_\_\_. 2020

**PËR**

**MIRATIMIN E UNIFORMES, SHENJAVE DALLUESE PËRKATËSE, FLAMURIN,  
STEMËN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e uniformës së shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, shenjat dalluese përkatëse, flamurin dhe stemën , sipas lidhjeve që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë për nivelin e mesëm dhe të lartë, sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë për nivelin bazë (operues), sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për uniformat zjarrduruese e personelit operues, sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Flamuri dhe stema janë Simbolet e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Shenjat dalluese të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin përbëhen nga: shenja e mbiemrit, shenja e kapelës, stema, logo e bashkisë përkatëse dhe shirita ceremoniale, sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

7. Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara me kërkesë të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe në emër e për llogari të tyre, kryen procedurën e prokurimit të uniformave të shërbimit të MZSH-së.
8. Vendimi nr. 78, datë 06.02.2003 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes për policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, shfuqizohet.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Brendshme, Agjencia për Blerjet e Përqëndruara dhe Kryetari i njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**SANDËR LLESHAJ**